

Në pajtim me Nenin 34 të Ligjit për NP dhe Nenin 36 të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 2007/02-L-123 (i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2008/26) (Rregullorja), këto Rregullore të reja janë miratuar në mënyrë të rregullt nga aksionari i Kompanisë me vendimin Nr. 324/1 me datën 09 dhjetor 2009 në Prishtinë, Kosovë.

Me të hyrë në fuqi këto Rregullore, shfuqizohen Rregulloret paraprake të Kompanisë, të datës 22 dhjetor 2005.

RREGULLORET E REJA

TË

KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS SH.A.

SEKSIONI I

DEFINICIONET DHE INTERPRETIMI

1. Definicionet

Në këto Rregullore

“**Mbledhja e Përgjithshme Vjetore**” ka kuptimin e paraqitur në Seksionin II(3);

“**Filial**” do të thotë: (i) çdo Ndërmarrje Publike tjetër (NP); (ii) çdo ndërmarrje që drejtpërdrejt ose tërthorazi kontrollohet nga Kompania ose një NP tjetër ose që është mbi 50% pronë e saj; (iii) çdo entitet ose ndërmarrje që, drejtpërdrejt apo tërthorazi, kontrollon një NP ose që posedon mbi 50% të aksioneve ose të interesave tjera pronësore të një NP.

“**Ligji në fuqi**” ose “**ligji**” nënkupton ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës, ku përfshihen: Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 2007/02-L-123 (i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2008/26) (“**Rregullorja**”) dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 2007/03-L-087 (“**Ligji për NP**”), të cilat plotësohen kohë pas kohe.

“**Komisioni i Auditimit**” nënkupton organin e përkufizuar në Seksionin IV;

“**Bordi i Drejtorëve**” nënkupton organin e përkufizuar në Seksionin III;

“**ZLE**” ose “**Zyrtari i Lartë Ekzekutiv**” ka kuptimin e përkufizuar në Seksionin V(3)(a);

“**ZLF**” ose “**Zyrtari i Lartë Financiar**” ka kuptimin e përkufizuar në Seksionin V(4);

“**Statuti**” nënkupton dokumentin themelues dhe më të lartë të Kompanisë, ashtu siç përkufizohet në Nenin 137 të Rregullores;

“**Kompania**” nënkupton Korporatën Energjetike e Kosovës Sh.A.

“**Kontroll**”, në lidhje me ndërmarrjen, nënkupton mbajtjen e shumicës së aksioneve me të drejtë vote (ose instrumentin përgjegjës) në ndërmarrjen përkatëse ose mundësinë që të ushtrojë ndikim dominues në marrjen e vendimeve që bëjnë pjesë në kompetencat e aksionarëve ose të organit më të lartë

NE

vendimmarrës të ndërmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes personave të tjerë apo në bashkëpunim me persona të tjerë, qoftë vetëm apo bashkë me persona të tjerë ose qoftë përmes votimit apo të drejtave kontraktuese ose ndryshe.

“Drejtor” nënkupton çdo anëtar të Bordit të Drejtorëve të Kompanisë;

“Interesi Financiar” nënkupton çfarëdo marrëdhënieje, përfshirë çfarëdo interesi pronësie, pa kufizim, që e mban personi përkatës ose një person i shkallës së katërt të lidhjes familjare (numri i shkallës përcakton raportin - martesën ose të qenit prind - dhe lidhjen familjare të një personi me një person tjetër, duke filluar nga stërgjyshi i parë i përbashkët e duke rënë te nivelet tjera (për shembull, dy vëllezër janë të afërm të shkallës së dytë, kurse dy kushërinj të parë janë të afërm të shkallës së katërt) ose i shkallës me te me të afërm, familjar i atij personi;

“Mbledhja e përgjithshme” ka kuptimin e përcaktuar në Seksionin II(2);

“Qeveria” nënkupton Qeverinë e Republikës së Kosovës;

“Zyrtari për Auditim të Brendshëm” ka kuptimin e përkufizuar në Seksionin V(5);

“Zyrtari” nënkupton çdo ZLE/DM, ZLF, Sekretar të Korporatës/Këshilltar të Përgjithshëm, Zyrtar për Auditim të Brendshëm;

“Ndërmarrje Publike” ose **“NP”** është term i përgjithshëm që nënkupton dhe përfshin të gjitha ndërmarrjet e përcaktuara në listat të cilat i janë bashkangjitur Ligjit për NP;

“Transaksioni me Palët e Ndërlidhura” nënkupton çdo transaksion, të çfarëdo natyre, nëpërmjet të cilit Kompania, në çfarëdo mënyre, pranon mallra apo shërbime nga çdo person fizik ose person juridik ose transferon mallra apo shërbime te çdo person fizik ose person juridik (**“Palë e Ndërlidhur”**), i cili:

(a) është filial i Kompanisë;

(b) është aksionar i Kompanisë ose ndonjëri prej Filialeve të saj që ka më shumë se 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të të drejtave të vendimmarrjes;

(c) ka qenë aksionar kontrollues i Kompanisë, në (3) tri vjetët e fundit;

(d) ka qenë drejtor, zyrtar ose menaxher i lartë i Kompanisë ose i cilësdo prej filialeve të saj, gjatë (5) pesë vjetëve të fundit;

(e) është biznes i lidhur me Kompaninë ose me ndonjërin prej filialeve të saj apo është drejtor, zyrtar ose menaxher i lartë i ndërmarrjes ose filialit të tillë;

(f) është ndërmarrje e përbashkët, pjesëmarrëse e të cilës është Kompania apo ndonjëri prej filialeve të saj, apo drejtor, zyrtar ose menaxher i lartë i një ndërmarrjeje të tillë;

(g) është i afërm i shkallës së tretë apo më i afërt me cilindo prej personave fizikë që kualifikohen në kategoritë e përmendura më sipër; ose

(h) është shoqëri tregtare apo person tjetër juridik që kontrollohet ose ndikohet në masë të konsiderueshme nga cilido person fizik apo person juridik që kualifikohet në kategoritë e mësipërme;

“Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm” ka kuptimin e përkufizuar në Seksionin V(6).

Interpretimi

(a) Në rastet kur cilado prej dispozitave të këtyre Rregulloreve është në konflikt me dispozitat e detyrueshme të ligjit aplikohet dispozita e këtyre Rregulloreve që është e lejuar me dispozitat përkatëse ligjore dhe ndërlidhen me to, në mënyrë që të mbështesë, për sa është e mundur, synimin e aksionarëve, të pasqyruar në mënyrë objektive në këtë statut.

(b) Po ashtu, këto Rregullore duhet të lexohen në lidhje me dispozitat e Kodit të Kompanisë për Qeverisjen e Korporative, të cilat kanë fuqi detyruese për Bordin e Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe Zyrarët për çështjet që i rregullon ai.

SEKSIONI II

AKSIONARËT

1. Regjistri i aksionarëve

Kompania krijon dhe mban një regjistër aksionarësh, në pajtim me ligjin. Ky regjistër përmban informacionet e kërkuara me ligj dhe çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm për Kompaninë.

Kompania nuk do të kërkojë pagesë për regjistrimin e ndonjë transferimi apo të ndonjë dokumenti tjetër që ka të bëjë me ndonjë te drejtë ose që ka ndikim në të drejtën në ndonjë aksion.

Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm mund të regjistrojë transferimin e një aksioni vetëm kur sigurohet dëshmia e transferimit, në pajtim me ligjin.

Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm lejon aksionarët, persona tjerë që lejohet me ligj dhe agjentëve të autorizuar të tyre që të shohin regjistrin e aksionarëve e të drejtorëve dhe, me kërkesë të tyre, u siguron ekstrakte nga regjistrat përkatës.

2. Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve

(a) Mbledhja e Përgjithshme e aksionarëve të Kompanisë (“Mbledhja e përgjithshme”) është organi më i lartë vendimmarrës i Kompanisë. Vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme, të cilat quhen rezoluta, kanë fuqi detyruese për Kompaninë, aksionarët, dhe Zyrarët e Kompanisë.

Nëse dhe përderisa aksionet e Kompanisë janë pronë e plotë e Republikës së Kosovës atëherë aplikohen kushtet e veçanta vijuese:

- (i) Qeveria ka kompetencën ekskluzive të ushtrojë të drejtat e aksionarit;
- (ii) Procedurat e përcaktuara në seksionet prej II 3.2 deri II 3.7 të këtyre Rregulloreve, të cilat kanë të bëjnë me Mbledhjen e Përgjithshme, zëvendësohen me Rregullore të punës të Qeverisë, ndërsa kuptimin e Mbledhjes së Përgjithshme e ka Mbledhja e Qeverisë. Por me kusht që Qeveria t’i votojë rezolutat që kanë të bëjnë me Kompaninë me shumicë të thjeshtë, dhe

- (iii) Ministri i Ekonomisë dhe Financave është përgjegjës për implementimin e vendimeve të Qeverisë deri në atë masë sa ato janë të lidhura me Kompaninë.

Procedurat e përshkruara prej Nenit II 3.2 deri te Neni II 3.7 të këtyre Rregulloreve mund të zbatohen sërish dhe në mënyrë plotë në momentin që pronësia e aksioneve të Kompanisë që i takojnë Republikës së Kosovës bie nën 100% (njëqind për qind).

3. Thirrja dhe Rendi i ditës së Mbledhjeve të Përgjithshme

(a) Kompania mban një Mbledhje e Përgjithshme në vit (Mbledhja e Përgjithshme Vjetore) për të shqyrtuar dhe miratuar pasqyrat financiare, brenda periudhës prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh pas përfundimit të vitit financiar të Kompanisë.

(b) Mbledhjet e Përgjithshme thirren nga kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, përmes Sekretarit të Korporatës/Këshilltarit të Përgjithshëm.

(c) Mbledhja e Përgjithshme mund të thirret nga Bordi i Drejtorëve, kurdo që konsiderohet e nevojshme; në të njëjtën mënyrë. Bordi i Drejtorëve mund të përfshijë çështje shtesë në rendin e ditës së Mbledhjes e Përgjithshme Vjetore.

(d) Dy apo më shumë anëtarë të Bordit të Drejtorëve apo aksionarë, të cilët kanë jo më pak se 20% (njëzet për qind) të aksioneve me të drejtë vote të emetuara ose paemetuara, mund të kërkojnë mbajtjen e Mbledhjes së Përgjithshme dhe të caktojnë edhe rendin e ditës. Kërkesa bëhet me shkrim dhe i drejtohet kryesuesit të Bordit të Drejtorëve. Ajo aprovohet nëse çështjet e propozuara bëjnë pjesë në kompetencën e Mbledhjes së Përgjithshme. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve e thërret Mbledhjen e Përgjithshme, jo më vonë se ditën e 40 (dyzetë) prej pranimit të kërkesës, me përjashtim kur në kërkesë saktësohet një datë e mëvonshme.

(e) Në mënyrë të njëjtë, siç është përcaktuar në seksionin II(3)(d), në rendin e ditës së Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore mund të përfshihen edhe çështjet plotësuese; një kërkesë e tillë nuk merret parasysh, në qoftë se ajo dorëzohet më vonë se ditën e 100 (njëqind) prej mbylljes së vitit financiar të Kompanisë. Në rast se një kërkesë e tillë bëhet pas njoftimit tashmë të dërguar për mbledhje, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore shtyhet dhe dërgohet një njoftim i ri, i cili përfshin edhe çështjet plotësuese të rendit të ditës.

4. Njoftimi për Mbledhjen e Përgjithshme dhe Procedurat

(a) Njoftimi për Mbledhjen e Përgjithshme i dërgohet secilit aksionar, së paku 30 (tridhjetë) ditë përpara, në adresat e secilit aksionar të shënuar në regjistrin e aksionarëve dhe të secilit anëtar të Bordit të Drejtorëve. Përveç kësaj, njoftimi bëhet i vlefshëm me publikimin e tij, ashtu siç kërkohet me ligjin në fuqi.

(b) Njoftimi përfshin kohën e vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës së saj. Njoftimi mund të sigurojë që, nëse nuk ka kuorum për Mbledhjen e Përgjithshme, atëherë ajo shtyhet për një datë tjetër, duke përcaktuar kohën dhe vendin; kjo datë nuk mund të jetë më herët se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe as më vonë se 30 (tridhjetë) ditë prej ditës fillestare.

(c) Mos dërgimi i njoftimit për Mbledhjen e Përgjithshme për cilindo aksionar korrigohet nëse në mbledhje merr pjesë personalisht aksionari apo i autorizuari i tij. Mos dërgimi i njoftimit për mbledhje për cilindo anëtar të Bordit të Drejtorëve korrigohet nëse në mbledhje marrin pjesë personalisht shumica e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

(d) Çfarëdo kërkesë për dërgim të njoftimit konsiderohet si e tërhequr në qoftë se Mbledhja e Përgjithshme e aksionarëve thirret përmes vendimit me shkrim, të nënshkruar nga të gjithë aksionarët e saj, në pajtim me seksionin II(7)(f).

(e) Mbledhjet e Përgjithshme mund të mbahen në më shumë se një lokacion, të cilat janë të lidhura midis tyre me pajisje për audio konferencë apo video konferencë, pasi të përmbushen kërkesat vijuese dhe të shënohen në procesverbalin përkatës:

- (i) Kryesuesi i Mbledhjes së Përgjithshme duhet të jetë në gjendje të vërtetojë identitetin e të pranishmëve dhe të drejtën e pjesëmarrjes së tyre, e kryeson Mbledhjen e Përgjithshme dhe vërteton e deklaron rezultatet e votimit;
- (ii) Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm i Mbledhjes së Përgjithshme duhet të jetë në gjendje që në mënyrë adekuate të perceptojë zhvillimet gjatë mbledhjes;
- (iii) Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutim dhe të votojnë lidhur me pikat e rendit të ditës, si edhe të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumente që kanë të bëjnë me të (në qoftë se ka ndonjë).

5. Kuorumi për Mbledhjen e Përgjithshme

(a) Mbledhja e Përgjithshme mund të mbahet nëse ka kuorum, ku janë të pranishëm vetë anëtarët apo të autorizuarit e tyre. Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm duhet të bëjë aranzhimet e nevojshme që aksionarët t'i regjistrojnë aksionet e tyre në Mbledhjen e Përgjithshme. Kuorumi i Mbledhjes së Përgjithshme është i mjaftueshëm në qoftë se si të pranishëm në të janë regjistruar aksionarët apo agjentët e tyre të autorizuar, të cilët përfaqësojnë së paku 50% (pesëdhjetë për qind) të aksioneve të Kompanisë me të drejtë vote.

(b) Nëse kuorumi i nevojshëm mungon brenda një periudhe të arsyeshme kohore, pas kohës së caktuar për fillimin e saj, Mbledhja e Përgjithshme anulohet apo shtyhet për një datë tjetër, të caktuar në njoftim, në qoftë se ai ekziston. Kuorumi i nevojshëm për mbledhjen e shtyrë është pjesëmarrja e aksionarëve apo e të autorizuarve të tyre, të cilët përfaqësojnë 25% (njëzet e pesë për qind) të aksioneve të Kompanisë me të drejtë vote. Në rast se kuorumi i nevojshëm i mbledhjes së shtyrë mungon brenda një periudhe të arsyeshme kohore, pas kohës së caktuar për fillimin e saj, Mbledhja e Përgjithshme anulohet.

6. Kryesuesi i Mbledhjes së Përgjithshme

Kryesuesi i Mbledhjes së Përgjithshme është kryesuesi i Bordit të Drejtorëve apo personi i zgjedhur nga pjesa më e madhe e aksioneve të paraqitura në Mbledhjen e Përgjithshme, sipas zgjedhjes së aksionarëve. Kryesuesi i mbledhjes, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe në përputhje me ligjin e me këtë Statut, vërteton prezencën e kuoromit, e udhëheq debatin, e siguron mbajtjen e procesverbalit dhe e vërteton dhe e deklaron rezultatin e votimit; Kryesuesi ndihmohet nga Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm.

7. Votat e Aksionarëve

(a) Çdo aksionar, emri i të cilit figuron në regjistrin e aksionarëve, 30 (tridhjetë) ditë para datës së mbledhjes së thirrur të aksionarëve, ka një votë për çdo aksion të regjistruar në emër të tij në regjistrin e aksionarëve të Kompanisë.

(b) Çdo autorizim i aksionarit bëhet me shkrim nga aksionari autorizues, ndërsa autorizimi merret nga Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm, para fillimit të Mbledhjes së Përgjithshme.

(c) Vota e personit të autorizuar është e vlefshme, edhe nëse personit që voton i është marrë më herët autorizimi, përveç nëse Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm është njoftuar për tërheqjen e autorizimit para fillimit të Mbledhjes së Përgjithshme në të cilën është dhënë vota.

(d) Vendimi i hedhur në votim në Mbledhjen e Përgjithshme merret pas numërimit publik të votave. Numërimi bëhet menjëherë, sipas udhëzimeve të Kryesuesit të Mbledhjes së Përgjithshme, ashtu që të mundësojë numërimin e saktë të votave që kanë të bëjnë me çdo aksion, "për" dhe "kundër" vendimit. Në rast të barazisë së votave "për" dhe "kundër", vendimtare për marrjen e vendimit do të jetë vota e Kryesuesit të Mbledhjes së Përgjithshme (nëse ai/ajo është aksionar).

(e) Mbledhja e Përgjithshme mund të miratojë vetëm vendimet që kanë të bëjnë me çështjet e përfshira në rendin e ditës së Mbledhjes së Përgjithshme të caktuar, në qoftë se aksionarët që i përfaqësojnë të gjitha aksionet e Kompanisë me të drejtë vote, të cilët janë prezentë në mbledhje, nuk vendosin ndryshe.

(f) Vendimi me shkrim, i nënshkruar nga të gjithë aksionarët e Kompanisë, ka fuqi dhe ndikim të njëjtë me vendimin e miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme, të thirrur e të mbajtur. Çdo vendim publikohet në disa ekzemplarë me formë e përmbajtje të njëjtë, të cilat nënshkruhen nga një apo më shumë aksionarë.

8. Kompetenca e Mbledhjes së Përgjithshme

(a) Nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj, kompetenca ekskluzive të Mbledhjes së Përgjithshme janë:

- (i) ndryshimi i Statutit dhe Rregulloreve të Kompanisë, miratimi i Kodit Korporativ të Kompanisë, përcaktimi i kriterëve për ushtrimin e kompetencave të organeve kompanisë, të përcaktuara me këtë statut dhe me ligj;
- (ii) rritja apo zvogëlimi i kapitalit aksionar të Kompanisë;
- (iii) krijimi i kategorive të ndryshme të aksioneve, përcaktimi i të drejtave dhe tipareve tjera të tyre, si edhe realizimi i tyre;
- (iv) vendimi për çfarëdo bashkimi, konsolidimi, ndarjeje, shpërbërjeje, likuidimi, transformimi dhe – për sa lejon ligji - falimentimin apo paaftësinë paguese e Kompanisë;
- (v) vendimi për emetimin e aksioneve, emetimin e detyrimeve apo letrave me vlerë të konvertueshme në aksione dhe konsolidimi apo ndarja e aksioneve të mbetura dhe të letrave të konvertueshme me vlerë;
- (vi) emërimi, heqja dhe zëvendësimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, si edhe përcaktimi i pagesës së kompensimit të tyre;
- (vii) përcaktimi i kompensimit plotësues që u takon drejtorëve që janë edhe anëtarë të Komisionit të Auditimit;
- (viii) autorizimi i çdo transaksioni në mes të Kompanisë dhe çdo drejtori; dhe

- (ix) deklarimi i ndonjë dividendi dhe marrja e vendimit mbi mbulimin e çfarëdo humbjeje.

(b) Miratimi i transaksioneve dhe dokumenteve të përcaktuara në seksionet II(8)(a)(viii) dhe (ix) nuk i liron drejtorët dhe zyrtarët e Kompanisë nga asnjë përgjegjësi që i përket shkeljes së detyrave të mirëbesimit apo nga obligimeve tjera ndaj Kompanisë, dhe nuk nënkupton heqjen dorë nga të drejtat dhe mjetet që Kompania mund të ndërmarrë ndaj tyre.

SEKSIONI III

BORDI I DREJTORËVE

1. Funksioni i Bordit të Drejtorëve

Biznesi dhe punët e Kompanisë udhëhiqen nga Bordi i Drejtorëve, ashtu siç parashihet me këto Rregullore dhe me ligjin në fuqi.

2. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve

(a) Bordi i Drejtorëve përbëhet nga më së paku 5 (pesë) dhe më së shumti 7 (shtatë) drejtorë. Numrin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve e përcakton Mbledhja e Përgjithshme, me rastin e zgjedhjes së secilit Bord të Drejtorëve. Mbledhja e Përgjithshme pastaj zgjedh një numër drejtorësh, i cili është i barabartë me një numër të tillë *minus* një (1). ZLE i Kompanisë, posa të emërohet nga Bordi i Drejtorëve, bëhet Drejtor sipas detyrës zyrtare (*ex officio*), me të njëjtat të drejta sikurse anëtarët e tjerë të Bordit të Drejtorëve; ZLE pushon të jetë Drejtor menjëherë pas shkarkimit të tij nga Bordi i Drejtorëve, për t'u zëvendësuar nga një ZLE tjetër.

(b) Me rastin e zgjedhjes së Bordit të Drejtorëve, Mbledhja e Përgjithshme e cakton kryesuesin dhe zëvendësin e tij, i cili do t'i kryejë funksionet e Kryesuesit, nëse ky i fundit mungon apo nuk e mban më atë post, (në rastin e fundit, vetëm derisa të emërohet Kryesuesi i ri). Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve nuk mund ta mbajë edhe postin e ZLE.

(c) Me zgjedhjen e Bordit të Drejtorëve, Mbledhja e Përgjithshme i cakton edhe anëtarët e Komisionit të Auditimit. Komisioni i Auditimit përbëhet nga 3 (tre) drejtorë, prej tyre së paku 2 (dy) anëtarë, nga përbërja e caktuar nga Mbledhja e Përgjithshme, do të kenë njohuri të lartë, apo së paku njohuri adekuate, nga kontabiliteti.

(d) Drejtorët zgjidhen për një mandat prej 3 (tre) vjetësh. Drejtorët zgjidhen sipas preferencës së aksionarëve dhe mund të shkarkohen në çdo kohë, me apo pa arsye, nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve, me përjashtim kur përcaktohet ndryshe me ligjin në fuqi. Megjithatë, nëse anëtarët e Bordit të Drejtorëve kompensohen, shkarkimi i tyre pa arsye bëhet i plotfuqishëm menjëherë, por nuk mund të paragjykojë të drejtën për ndonjë shpërblim të dëmeve apo për kompensim të drejtë që mund t'i takojnë në bazë të ligjit në fuqi.

3. Kualifikimi

(a) Përveç ndonjë kërkesë tjetër që përcaktohet me ligjin në fuqi, për të qenë i kualifikuar për t'u zgjedhur Drejtor, një person duhet të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë – së paku në nivelin më të lartë të menaxhmentit – në administrim të biznesit, financa të korporatave, financa, menaxhim të thesarit, sistem bankar, miniera, konsulencë afariste ose industriale ose duhet të ketë përvojë së paku 5 (pesë) vjet përvojë si kontabilist publik, avokat i kualifikuar apo inxhinier civil.

(b) Personat që nuk kanë njohuri bazë për kontabilitet, që janë deklaruar të falimentuar në 10 (dhjetë) vjetët e fundit, apo që janë shpallur fajtorë për vepra penale ose kundërvajtje, sipas ligjeve dhe Rregulloreve të aplikueshme në Kosovë ose në ndonjë shtet apo juridiksion, apo sipas traktateve apo konventave ndërkombëtare, duke përfshirë mashtrimin, përfaqësimin e paautorizuar, vjedhjen, pastrimin e parave, keqpërdorimin ose përvetësimin e paautorizuar të fondeve, mitosjen ose haraçin, nuk mund të kualifikohen.

(c) Personat që janë: (i) punëtorë, zyrtarë, drejtorë apo aksionarë ose që kanë interes financiar në ndonjë organizatë biznesi të regjistruar që konkurren me Kompaninë; (ii) menaxherë të lartë, zyrtarë, drejtorë apo aksionarë që mbajnë më shumë se 2% (dy për qind) të të drejtave të votimit apo që kanë interes të dukshëm financiar në ndonjë organizatë biznesi të regjistruar që konkurren me Kompaninë, nuk mund të kualifikohen.

(d) Përveç kësaj, të gjithë drejtorët, përveç ZLE, duhet të jenë të pavarur; ashtu siç përcaktohet me ligjin në fuqi.

(e) Çdo zgjedhje e bërë në kundërshtim me dispozitat e Seksionit III(3) është e pavlefshme dhe anulohet. Si e tillë, ajo mund të kundërshtohet para gjykatave kompetente nga ndonjë aksionar apo drejtor i Kompanisë.

4. Kompetencat dhe detyrat e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve, nën përgjegjësinë e tij kolektive:

(a) vepron në përputhje me Statutin dhe me Rregulloret e Kompanisë dhe implementon vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme, në pajtim me ligjin;

(b) përcakton dhe shqyrton rregullisht – së paku çdo tre muaj – strategjinë e Kompanisë;

(c) përgatit dhe miraton planin afatgjatë strategjik të investimit, planin financiar të Kompanisë dhe, gjatë periudhës relevante, e shqyrton atë kurdo që është e nevojshme, së paku çdo tre muaj, dhe bën çfarëdo ndryshimi që kërkohet;

(d) bazuar në planin afatgjatë, i jep udhëzime strategjike ZLE-së, kurdo që e konsideron të nevojshme;

(e) miraton planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor, të përgatitur nga ZLE, në bazë të planit afatgjatë;

(f) emëron, shkarkon dhe zëvendëson zyrtarët e Kompanisë (siç është përcaktuar më poshtë). Zyrtarët shërbejnë sipas vullnetit të Bordit të Drejtorëve, Bordi, në çdo kohë, përmes votave të shumicës, mund të shkëpusë kontratat e tyre, me ose pa arsye. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme, Komisioni i Auditimit është autoritet ekskluziv për emërimin, shkarkimin dhe zëvendësimin e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm, i cili shërben sipas vullnetit të Komisionit të Auditimit, dhe, në çdo kohë, me shumicë votash, ia ndërprente kontratën, me apo pa arsye. Bordi i Drejtorëve kujdeset që përzgjedhja e zyrtarëve të bëhet në pajtim me kërkesat vijuese:

- (i) përzgjedhja duhet të bëhet përmes një konkurrence të hapur e transparente, e cila ka për synim të sigurojë se të gjithë zyrtarët e caktuar janë zgjedhur në bazë të meritës;
- (ii) kandidatët duhet të kenë përgatitje të duhur profesionale dhe arsimimin e kërkuar për pozitën e zyrtarit, me kusht që: (i) ZLF duhet të ketë së paku universitetin dhe përvojë të

konsiderueshme në financat e biznesit dhe në kontabilitet; (ii) Këshilltari i Përgjithshëm/Sekretari i Korporatës duhet të ketë së paku fakultetin juridik dhe përvojë të konsiderueshme në qeverisjen e korporatës ose në ligjin për shoqëritë tregtare; dhe Zyrtari për Auditim të Brendshëm duhet të jetë së paku ekspert i kontabilitetit; dhe

(iii) të gjithë zyrtarët e Kompanisë duhet të jenë të kualifikuar në pajtim me dispozitat e specifikuar në ligjin në fuqi.

(g) përcakton transaksionet lidhur me të cilat ZLE nuk do të ketë kompetencë të veprorë dhe ta obligojë Kompaninë në mënyrë të pavarur, për çka duhet të kërkojë autorizimin paraprak të Bordit të Drejtorëve apo nënshkrimin e ndonjë zyrtari tjetër;

(h) me propozim të ZLE, përcakton transaksionet financiare lidhur me të cilat ZLF do të ketë kompetencë të veprorë (dhe ta obligojë Kompaninë) në mënyrë të pavarur, dhe duhet ta kërkojë autorizimin paraprak të ZLE ose të Bordit të Drejtorëve;

(i) bën mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe rigoroze lidhur me drejtimin e biznesit të Kompanisë, lidhur me performansën e Zyrtarëve të Kompanisë dhe performansën e Kompanisë dhe siguron që vija e raportimit në Kompani është e organizuar ashtu që të jetë i mundur ushtrimi i duhur i detyrës së mbikëqyrjes dhe, bazuar në këtë, zbatimin e detyrave të besuara të zyrtarëve (në rastin e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm vetëm me propozim të Komisionit të Auditimit);

(j) në fund të çdo viti afarist, pa vonesë të madhe dhe, në çfarëdo rasti, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh prej përfundimit të vitit financiar të Kompanisë, miraton:

(i) bilancin vjetor dhe raportin e fitimit dhe humbjeve të Kompanisë dhe të gjitha raportet tjera financiare që kërkohen me ligj;

(ii) raportin vjetor mbi menaxhmentin, politikën e biznesit dhe gjendjen financiare dhe industriale të Kompanisë – i cili përfshin komentet, në mënyrë që operimet dhe performansa e Kompanisë të jenë në përputhje me planin afatgjatë – po ashtu përshkrimin e propozimit të tij për alokim të mjeteve, investim apo distribuim të profiteve vjetore, apo për mbulim të humbjeve; dhe

(iii) deklaratën për aksionarët se – në bazë të njohurive më të mira të Bordit të Drejtorëve, në bazë të raportit të Komisionit të Auditimit dhe hulumtimit të pavarur e të kujdesshëm dhe shqyrtimit adekuat të tij - dokumentet e mësipërme janë të vërteta, të drejta e të sakta dhe nuk kanë ndonjë mungesë informacioni apo deklarate, mungesa e së cilës do të shkaktoje çorientim.

dhe bën dorëzimin e tyre – së bashku me raportin e Auditorit të Jashtëm lidhur me dokumentet e përcaktuara në paragrafin (i) – më sipër, te aksionarët;

(k) sigurohet se sistemet adekuate të kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe atë financiar, janë në funksion;

(l) sigurohet se sistemet adekuate dhe procedurat janë në funksion për të garantuar se pasqyrat dhe të dhënat e Kompanisë, përfshirë edhe të dhënat financiare, mbahen në përputhje me standardet e aplikueshme të kontabilitetit dhe me ligjet, dhe se draftet e raporteve vjetore financiare janë përgatitur si duhet;

(m) sigurohet se Kompania i nënshtrohet auditimit të jashtëm vjetor, objektiv, i cili do të realizohet nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar;

(n) sigurohet se sistemet adekuate dhe procedurat janë në funksion për të garantuar se Kompania i respekton të gjitha ligjet e aplikueshme gjatë kryerjes së biznesit dhe punëve të saj;

(o) me propozim të ZLE, i identifikon standardet adekuate për matjen e rregullt të performansës së Kompanisë;

(p) sigurohet se biznesi i Kompanisë nuk devijon asnjëherë nga qëllimi i caktuar në Statutin, pa autorizim të qartë të Mbledhjes së Përgjithshme, dhe

(q) duke u bazuar në politikën e hartuar nga Komisioni i Auditimit, përcakton pagat e zyrtarëve.

Përveç kësaj, Bordi i Drejtorëve mund t'i japë udhëzime ZLE mbi organizimin e brendshëm të Kompanisë dhe mbi caktimin përgjegjësive dhe të autoritetit vendimmarrës në mesin e zyrtarëve të Kompanisë.

5. Mbledhjet

(a) Bordi i Drejtorëve takohet në vendin e caktuar në njoftimin me shkrim për mbajtjen e mbledhjes, në zyrën e regjistruar të Kompanisë apo diku tjetër, kurdo që konsiderohet e nevojshme nga Kryesuesi apo nga 2 (dy) apo më shumë drejtorë, ose me kërkesë të Komisionit të Auditimit. Njoftimi për mbledhjen përfshin rendin e ditës dhe dorëzohet së paku tri ditë para mbledhjes së Bordit, personalisht, me faks, me postë elektronike apo në çfarëdo mënyre tjetër që siguron pranimin e tij me kohë. Në rast të urgjencës, njoftimi i mbledhjes dërgohet me letër të dorëzuar personalisht, me faks apo me e-mail, së paku 1 (një) ditë para mbledhjes.

(b) Në mbledhje, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe në përputhje me ligjin në fuqi dhe me këtë statut, vërteton prezencën e kuorumit, e udhëheq debatin dhe mbajtjen e procesverbalit, dhe vërteton e deklaron rezultatin e votimit. Kryesuesi ndihmohet nga Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm, derisa konfidencialiteti i çështjes të mos kërkojë që njëri Drejtor të veprojë si Sekretar i Korporatës/Këshilltar i Përgjithshëm i mbledhjes.

(c) Anëtar i Bordit mund të mos marrë pjesë në mbledhjen e Bordit, duke autorizuar përfaqësuesin e tij apo duke dërguar votën përmes postës.

(d) Vendimet e Bordit të Drejtorëve janë valide nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e drejtorëve në detyrë dhe nëse ato merren me votën e shumicës së drejtorëve që marrin pjesë në mbledhje. Votat e drejtorëve që abstenojnë nga votimi dhe atyre që kanë ndonjë konflikt interesi nuk përfshihen në numërim në anën e shumicës. Në rast të ndonjë barazimi, vendimtare është vota e Kryesuesit.

(e) Nëse, për shkak të vendeve të lira, numri i drejtorëve është më i vogël se sa numri që është i caktuar për kuorum, drejtorët e mbetur (ose drejtori) mund të marrin vendim vetëm që të thirret Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve për plotësimin e vendeve të lira.

(f) Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve mund të mbahen në më shumë se një vend, të lidhur midis tyre përmes audio konferencës apo video konferencës, nëse plotësohen kërkesat e mëposhtme dhe nëse, si të tilla, pasqyrohen në procesverbalin përkatës:

- (i) kryesuesi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të verifikojë identitetin dhe të drejtën e atyre që kanë ardhur për të marrë pjesë, të kryesojë mbledhjen dhe të vërtetojë e të deklarojë rezultatet e votimit;
- (ii) Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm duhet të jetë në gjendje të perceptojë në mënyrë të duhur zhvillimet në mbledhje; dhe
- (iii) pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutim e në votimin e pikave të rendit të ditës dhe të lexojnë, të marrin apo dërgojnë dokumente që kanë të bëjnë me to (nëse ka).

(g) Vendimi me shkrim, i nënshkruar nga shumica e të gjithë drejtorëve, ka fuqi dhe efekt të njëjtë me një vendim të miratuar në Mbledhjen e Bordit, që është thirrur dhe është mbajtur. Çdo vendim i tillë përbëhet nga disa ekzemplarë, të cilët kanë formë e përmbajtje të njëjtë, dhe secili prej tyre nënshkruhet nga një apo nga më shumë drejtorë.

6. Pagat e drejtorëve

Drejtorët paguhen me një honorar themelor, të caktuar me vendim me shkrim, të miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme, për kohën e kaluar në mbledhjet e Bordit. Përveç kësaj, drejtorët kanë të drejtë për çdo pagesë tjetër apo përfitim nga Kompania, me kusht që kjo të jetë në pajtim me ligjin në fuqi.

SEKSIONI IV

KOMISIONI I AUDITIMIT

1. Funksioni i Komisionit të Auditimit

Përveç detyrave të tjera të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm, Komisioni i Auditimit verifikon nëse biznesi dhe punët e kompanisë kryhen në mënyrë të ligjshme, me përgjegjësi dhe në interesin ekskluziv të aksionarëve, ashtu siç parashihet në këtë statut dhe me ligjin e aplikueshëm. Kompetencat e Komisionit të Auditimit janë ekskluzive.

2. Anëtarët e Komisionit të Auditimit

(a) Komisioni i Auditimit përbëhet nga 3 (tre) drejtorë, të caktuar nga aksionarët, ashtu siç parashihet në pjesën III (2)(c).

(b) Komisioni i Auditimit cakton kryesuesin e vet.

3. Kompetencat dhe detyrat e Komisionit të Auditimit

Përgjegjësitë e veta kolektive të Komisionit të Auditimit janë:

(a) të respektojë Statutin dhe Rregulloret e Kompanisë;

(b) të shqyrtojë planin afatgjatë strategjik, investues e financiar të Kompanisë dhe çdo ndryshim të tij, si edhe planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor, para se ai të miratohet nga Bordi i Drejtorëve, si dhe t'i ofrojë Bordit këtë të fundit ndonjë koment apo kundërshtim që e sheh të arsyeshme;

(c) T'i shqyrtojë dokumentet e përcaktuara në pjesët III(4)(j)(i) dhe III(4)(j)(ii), , para se ato të miratohen nga Bordi i Drejtorëve, dhe t'i paraqesë Bordit të Drejtorëve raport për përshtatshmërinë, saktësinë, vërtetësinë dhe përputhshmërinë me ligjin të këtyre dokumenteve.

(d) të shqyrtojë rregullisht gjendjen financiare të kompanisë dhe kushtet e planifikuara financiare të saj dhe t'i paraqesë Bordit të Drejtorëve çfarëdo komenti apo propozimi që e sheh të arsyeshëm;

(e) të verifikojë rregullisht përshtatshmërinë dhe funksionimin e duhur të kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe atë financiar, dhe t'i paraqesë Bordit të Drejtorëve çfarëdo komenti apo propozimi që e sheh të arsyeshëm;

(f) të verifikojë rregullisht përshtatshmërinë dhe funksionimin e duhur të sistemeve dhe procedurave që kanë për synim garantimin se librat dhe të dhënat e kompanisë, përfshirë edhe të dhënat financiare, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjet aplikueshme, si edhe të përgatisë si duhet draftet e deklaratave financiare vjetore dhe t'i ofrojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo komenti apo propozimi që e sheh të arsyeshëm;

(g) të verifikojë rregullisht përshtatshmërinë dhe funksionimin e duhur e sistemeve dhe procedurave që kanë për synim garantimin se kompania i respekton të gjitha ligjet e aplikueshme, gjatë afarizmit dhe punës së saj, dhe t'i ofrojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo komenti apo propozimi që e sheh të arsyeshëm;

(h) të emërojë, të shkarkojë dhe të zëvendësojë Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm dhe të caktojë pagesën e tij/saj.

(i) të sigurohet që Zyra e Auditimit të Brendshëm është e organizuar mirë dhe ka personelin e nevojshëm, të verifikojë rregullisht përshtatshmërinë dhe funksionimin e saj, të bëjë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë të punës së Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Brendshëm;

(j) të ndihmojë Zyrtarin e Prokurimit të Kompanisë të caktojë kriteret e përshtatshme profesionale që do të përdoren në aktivitetet e prokurimit për auditorët e jashtëm të Kompanisë. Komisioni i Auditimit po ashtu do të krijojë ato dispozita të kontratës në lidhje, e cila krijon planin për auditimin e jashtëm;

(k) të shqyrtojë të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura, t'i lejojë transaksionet kushtet e të cilave janë të arsyeshme e të qëlluara për Kompanisë ose, aty ku vlen Seksioni VII(5), t'i këshillojë aksionarët për arsyeshmërinë dhe qëllueshmërinë e tyre;

(l) t'i hartojë rekomandim për Bordin e Drejtorëve për pagën e zyrtarëve të Kompanisë;

(m) të ruajë konfidencialitetin e plotë të ndonjë raportimi joanonim të punëtorëve lidhur me ndonjë keqpërdorim të dyshuar të drejtorëve, zyrtarëve apo punëtorëve tjerë të kompanisë, të mbrojë identitetin e punëtorëve që mund të jenë objekt i hakmarrjes dhe ta informojë atë lidhur me rezultatin e hetimit; duke ruajtur plotësisht informatat konfidenciale, dhe

(n) t'i propozojë Bordit të Drejtorëve zbatimin e detyrave të mirëbesimit të Zyrtarit për Auditim të Brendshëm.

4. Autorizimet e Komisionit të Auditimit

Komisioni i Auditimit është i autorizuar:

- (a) të udhëzojë Zyrtarin për Auditim të Brendshëm për kryerjen e detyrave dhe veprimeve që bëjnë pjesë në kompetencat e Komisionit të Auditimit;
- (b) të sigurojë çdo informatë lidhur me afarizmin dhe punët e Kompanisë, nga ZLE, ZLF, Sekretari dhe secili punëtor i Kompanisë;
- (c) të kërkojë këshilla nga profesionistë të pavarur, të zgjedhur nga ai (Komisioni), kurdo që çështja kërkon me arsye mendimin e këshilltarëve të pavarur;
- (d) të kërkojë mbajtjen e mbledhjes së Bordit të Drejtorëve, duke paraqitur rendin e ditës;
- (e) të paraqesë në gjykata apo në organet kompetente për zbatimin e ligjit çdo çështje në lidhje me Kompaninë; dhe
- (f) të rezervohet t'i japë Bordit të Drejtorëve çfarëdo informate në lidhje me aktivitetet e veta, për të cilat me arsye kërkohet konfidencialitet derisa të përfundojë një aktivitet i tillë.

5. Mbledhjet

- (a) Komisioni i Auditimit takohet në vendin e caktuar në njoftimin me shkrim për mbajtjen e mbledhjes, në zyrën e regjistruar të Kompanisë apo diku tjetër. Komisioni i Auditimit takohet sa herë që takohet Bordi i Drejtorëve, para mbledhjes së Bordit apo kurdo që konsiderohet e nevojshme nga secili anëtar i Komisionit të Auditimit. Njoftimi për mbajtjen e mbledhjes, i cili përfshin rendin e ditës, dërgohet së paku 3 (tri) ditë para mbledhjes, me dorë, me faks ose me e-mail apo në ndonjë mënyrë tjetër që siguron pranim me kohë. Në rast të urgjencës, njoftimi për mbledhje përcillet me letër, të dërguar në dorë, me faks ose me e-mail, së paku 1 (një) ditë para mbledhjes së Bordit.
- (b) Në mbledhje, Kryesuesi i Komisionit të Auditimit, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe me këtë Statut, vërteton praninë e kuorumit, e udhëheq debatin, siguron mbajtjen e procesverbalit dhe vërteton e shpall rezultatin e votimit. Kryesuesi, sipas përcaktimit të tij, mund të ndihmohet nga Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm.
- (c) Vendimet e Komisioni i Auditimit janë valide nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve në detyrë dhe nëse merren me votën "pro" të 2 (dy) anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Votat e anëtarëve që abstenojnë nga votimi dhe atyre që kanë ndonjë konflikt interesi nuk përfshihen në numërim sa i përket shumicës. Në rast të ndonjë barazimi, vendimtare është vota e Kryesuesit.
- (d) Në rast të ndonjë pozite të lirë, anëtarët tjerë e thërrasin, pa vonesë, Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve, për ta plotësuar vendin e lirë.
- (e) Mbledhjet e Komisionit të Auditimit mund të mbahen në më shumë se një vend, të lidhura midis tyre me pajisje për audio konferencë apo video konferencë, nëse plotësohen kërkesat e mëposhtme, të cilat pasqyrohen në procesverbalin përkatës:
 - (i) Kryesuesi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të verifikojë identitetin dhe të drejtën e atyre që kanë ardhur për të marrë pjesë, të kryesojë mbledhjen dhe të vërtetojë e të deklarojë rezultatet e votimit;

- (i) Kryesuesi (apo Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm i mbledhjes nëse është i pranishëm) duhet të jetë në gjendje të perceptojë në mënyrë të duhur zhvillimet në mbledhje; dhe
- (ii) Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutimin dhe në votim lidhur me pikat e rendit të ditës dhe të lexojnë, të marrin apo të dërgojnë dokumente që kanë të bëjnë me ta (nëse ka).

(f) Vendimi me shkrim, i nënshkruar nga së paku dy (2) anëtarë të Komisionit të Auditimit, ka fuqi dhe efekt të njëjtë me vendimin e miratuar në mbledhjen e Komisionit të Auditimit, të thirrur e të mbajtur. Çdo vendim përbehet nga disa ekzemplarë që kanë formë e përbajtje të njëjtë, të cilat nënshkruhen nga një apo më shumë anëtarë.

SEKSIONI V

ZYRTARËT

1. Zyrtarët e Kompanisë

Zyrtarë të Kompanisë janë: Zyrtari i Lartë Ekzekutiv, Zyrtari i Lartë Financiar/Thesarit, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm dhe Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm.

2. Kualifikimi

Përveç ndonjë kufizimi shtesë që del nga ligji në fuqi ose nga ndonjë dispozitë tjetër e këtyre Rregulloreve, personat që janë: (i) punëtorë, zyrtarë, drejtorë apo aksionarë ose personat që kanë ndonjë interes financiar në ndonjë organizatë afariste të peregjistruar, e cila konkurren me Kompaninë, ose (ii) menaxherë të lartë, zyrtarë, drejtorë apo aksionarë që mbajnë më shumë se 2% (dy për qind) të të drejtave të votës ose që kanë interes financiar në ndonjë organizatë afariste të regjistruar, e cila konkurren me Kompaninë, nuk mund të jetë Zyrtar/e i/e Kompanisë.

3. Zyrtari i Lartë Ekzekutiv

(a) Zyrtari i Lartë Ekzekutiv i Kompanisë ("ZLE") është kompetent të lidhë kontrata në emër të Kompanisë, në përputhje me Statutin, me këto Rregullore dhe me ligjin në fuqi, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve, sipas seksionit III(4)(g).

(b) Biznesi, punët dhe organizimi i Kompanisë bëhet nën drejtimin, mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e Zyrtarit të Lartë Ekzekutiv, në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e Kompanisë dhe me vendimet e Bordit të Drejtorëve. Për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me biznesin e Kompanisë, të cilat nuk janë në kompetencë të Mbledhjes së Përgjithshme, Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit për Auditim të Brendshëm vendos Zyrtari i Lartë Ekzekutiv ose ato janë nën udhëheqjen dhe përgjegjësinë e tij.

(c) ZLE është kompetent për punësimin dhe shkarkimin e zyrtarëve dhe të personelit të Kompanisë, por këtë kompetencë mund ta delegojë edhe te anëtarët e stafit. Për dallim nga të mëparshmit, (i) Zyrtari i Lartë Financiar, (ii) Zyrtari për Auditim të Brendshëm dhe (iii) Sekretari i Korporatës/Këshilltari i

Përgjithshëm punësohen dhe shkarkohen vetëm nga Bordi i Drejtorëve ose (nëse përcaktohet) nga Komisioni i Auditimit.

(d) ZLE i kryen edhe këto punë e përgjegjësi:

- (i) këshillon dhe ndihmon Bordin e Drejtorëve në hartimin e strategjisë së Kompanisë dhe të planit të saj strategjik afatgjatë;
- (ii) merr pjesë në përzgjedhjen e ZLE (Drejtorit Financiar dhe Sekretarit të Korporatës/Këshilltarit të Përgjithshëm);
- (iii) ia përgatit dhe ia dorëzon Bordit të Drejtorëve draftet e dokumenteve të përfshira në seksionet III(4)(j)(i) dhe III(4)(j)(ii);
- (iv) kurdo që është e nevojshme, të paktën në çdo tre muaj, Bordit të Drejtorëve ia paraqet raporte lidhur me transaksionet kryesore të kryera nga Kompania dhe vendimet kryesore të marra nga menaxhmenti për kryerjen e biznesit dhe punëve të Kompanisë;
- (v) ia përgatit e dorëzon Bordit të Drejtorëve dokumentet, letrat dhe informatat lidhur me të gjitha çështjet që janë përfshirë në rendin e ditës të mbledhjeve të tij;
- (vi) ia propozon Bordit të Drejtorëve standardet adekuate për matjen e performansës e Kompanisë dhe, të paktën çdo tre muaj, i paraqet Bordit të Drejtorëve raporte të rregullta për matjen e performansës së Kompanisë, duke marrë parasysh këto standarde;
- (vii) krijon dhe shqyrton strukturën organizative të kompanisë dhe përcakton përgjegjësitë vendimmarrëse dhe autorizimet për krijimin e obligimeve në emër të kompanisë, të zyrtarëve dhe punëtorëve të Kompanisë;
- (viii) ia siguron Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe ndihmën që mund ta kërkojë ai; dhe
- (ix) i siguron Zyrtarit për Auditim të Brendshëm të gjitha informatat dhe ndihmën që mund ta kërkojë ai;

4. Zyrtari i Lartë Financiar

Zyrtari i Lartë Financiar ("ZLF") i Kompanisë, nën udhëheqjen e mbikëqyrjen e ZLE, i menaxhon punët financiare të Kompanisë, me kusht që të jenë në kuadër të niveleve të lejuara nga Bordi i Drejtorëve, është kompetent të lidhë kontrata për të gjitha transaksionet financiare të Kompanisë dhe është përgjegjës:

- (a) të mbajë llogaritë e përditësuara dhe të sakta të Kompanisë;
- (b) të themelojë dhe drejtojë të gjitha kontrollet e brendshme financiare, përfshirë llogarite e pagueshme, llogarite e arkëtueshme dhe mjetet themelore;
- (c) të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave e të blerjeve të veçanta;

- (d) të shqyrtojë shpenzimet e punëtorëve për të siguruar përputhmëni me politikat korporative dhe me buxhetin e Kompanisë, para se të paguajë;
- (e) t'i përgatisë të dhënat e Kompanisë për auditimin e fundvitit;
- (f) të shqyrtojë e organizojë prokurimin, dhe mirëmbajtjen e të gjitha politikave të sigurimit që kanë të bëjnë me afarizmin e Kompanisë;
- (g) të koordinojë funksionet tjera të biznesit, siç është dhënia me qira e objekteve apo e pajisjeve, si edhe blerjeve, bashkë me ZLE dhe zyrën apo funksionin e prokurimit të Kompanisë;
- (h) të menaxhojë thesarin e Kompanisë;
- (i) të hartojë dhe prezantojë buxhetin; dhe
- (j) të kryejë çdo detyrë tjetër që i caktohet nga ZLE.

5. Zyrtari për Auditim të Brendshëm

Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komisionit të Auditimit dhe duke i raportuar ekskluzivisht këtij komisioni, Zyrtari për Auditim të Brendshëm është kompetent:

- (a) të drejtojë, të menaxhojë dhe të organizojë Zyrën për Auditim të Brendshëm, duke përfshirë edhe përzgjedhjen e stafit të saj;
- (b) të kryejë dhe të drejtojë të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm; dhe
- (c) të kryejë çdo detyrë tjetër të caktuar nga Komisioni i Auditimit.

6. Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm

(a) Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm i Kompanisë është kompetent:

- (i) të mirëmbajë regjistrin e aksionarëve;
- (ii) të veprojë si agjent i Kompanisë për pranimin e njoftimeve;
- (iii) t'i bëjë të gjitha skedimet, publikimet dhe shpalosjet e nevojshme te autoritetet kompetente, ashtu siç kërkohet me ligj dhe me këtë Statut.
- (iv) të mbikëqyrë mirëmbajtjen dhe azhurnimin e rregullt të ueb-faqes së paraparë me nenin VIII(6);
- (v) të këshillojë Bordin e Drejtorëve lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tij, sipas këtyre Rregulloreve dhe ligjit në fuqi; dhe
- (vi) të koordinojë me ZLE punët lidhur me përgatitjen e dokumenteve për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.

MF

(b) Sekretari i Korporatës/Këshilltari i Përgjithshëm e mban procesverbalin e Mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe të Komisionit të Auditimit (nëse nuk vendoset ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe bën regjistrimin e tij në librin e procesverbalit. Procesverbali i përmban këto informata: emrat e pjesëmarrësve, vendin dhe datën e mbajtjes së mbledhjes, çështjet kryesore që paraqiten gjatë diskutimeve në lidhje me pikat e veçanta të rendit të ditës, tekstet e vendimeve të propozuara, rezultatet e çdo votimi dhe votimet e secilit person, tekstet e vendimeve të miratuara dhe çdo kundërshtim të paraqitur në lidhje me vendimet e marra;

(c) Procesverbali i çdo mbledhjeje të Bordit të Drejtorëve paraqitet për miratim në mbledhjen vijuese të Bordit të Drejtorëve. Procesverbali i çdo mbledhjeje të Bordit të Drejtorëve nënshkruhet nga kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe u shpërndahet anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Të njëjtat rregulla vlejné edhe për procesverbalin e Komisionit të Auditimit.

SEKSIONI VI

DETYRAT E BESUARA

Secilit drejtor apo zyrtar i besohen nga Kompania punë e detyra të caktuara, në përputhje me ligjin ne fuqi. Në kuadrin e kryerjes së detyrave të besuara, zyrtari i kompanisë është obliguar:

(a) të veprojë në mirëbesim ekskluzivisht në dobinë kolektive dhe objektive të aksionarëve, përherë në përputhje me ligjin dhe këto Rregullore;

(b) të ushtrojë autorizimet që i janë dhënë ekskluzivisht në përputhje me interesat më të mira kolektive dhe objektive të aksionarëve;

(c) t'u kushtojë vëmendje çështjeve që vendosen prej tij dhe të sigurojë të gjitha informatat që janë të nevojshme për të marrë vendime të tilla, duke marrë parasysh kompleksitetin e tyre;

(d) t'u shmanget dhe të shpalosë konfliktet aktuale apo të mundshme të interesave të tij personale (të drejtpërdrejta ose të tërthorta) dhe interesave të Kompanisë.

(e) të kryejë me kujdes, me zell dhe me shkathtësi të arsyeshme të gjitha detyrat e tij; dhe

(f) t'i trajtojë me konfidencialitet të gjitha informatat që i merr në saje të pozitës së tij apo gjatë kryerjes së punëve e detyrave të tij.

SEKSIONI VII

KONFLIKTET E INTERESIT

1. Drejtorët dhe zyrtarët e kompanisë nuk mund të lidhin marrëveshje me Kompaninë, pa miratimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve.

2. Drejtorët dhe zyrtarët paraqesin para Bordit të Drejtorëve, me shkrim e në mënyrë të plotë e të ndershme, çdo interes personal të çfarëdo natyre që mund të kenë me rastin e çfarëdo veprimi apo vendimi që ka të bëjë me afarizmin e Kompanisë. Në veçanti, ata paraqesin çfarëdo interesi financiar që mund të kenë nga:

- (a) afaristët konkurrentë të Kompanisë;
 - (b) kreditorët e Kompanisë;
 - (c) furnizuesit me mallrave a shërbime të Kompanisë; dhe
 - (d) afaristët klientë të Kompanisë.
3. Shpalosjet e kërkuara me nenin paraprak bëhen nga secili individ, në kohën kur paraqitet interesi i caktuar apo në kohën kur individi e merr pozitën e caktuar në Kompani.
 4. Drejtorët abstenojnë nga vendimet lidhur me çështjet nga të cilat kanë interes personal (përfshirë edhe interesin financiar) apo që është e mundur të bien ndesh me interesin e Kompanisë; vendimet e miratuara nga Bordi i Drejtorëve ose nga Komisioni i Auditimit, në bazë të votave që i zotërojnë drejtorët e njollosur, janë të pavlefshme dhe çdo aksionar apo drejtor mund t'i kontestojë ato para gjykatave kompetente.
 5. Zyrtarët abstenojnë nga marrja e vendimeve për të gjitha çështjet nga të cilat ata kanë interes personal (përfshirë interesin financiar) dhe për veprime që është e mundshme të bien ndesh me interesin e Kompanisë, me përjashtim në rast se me një veprim të tillë ata e zbatojnë një vendim që është marrë nga Bordi i Drejtorëve ose për çka janë autorizuar shprehimisht nga Komisioni i Auditimit.

SEKSIONI VIII

RAPORTIMI

1. Raportet e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve, pas çdo mbledhjeje të tij, harton një raport të shkurtër e të qartë, i cili përfshin edhe një përmbledhje të përfundimeve e të rezolutave më të rëndësishme që janë marrë në mbledhje, duke ruajtur të gjitha informatat të cilat kërkojnë një shkallë të arsyeshme konfidencialiteti; informatat e tilla përfshihen në raportet e mëvonshme, kur nuk kërkohet më ruajtja e konfidencialitetit.

2. Informatat afariste dhe financiare

Bordi i Drejtorëve harton rregullisht - të paktën një herë në tre muaj - raport të shkurtër e të qartë, i cili përfshin edhe një përmbledhje të afarizmit të kompanisë dhe të kushteve financiare, duke theksuar - kur kjo është e nevojshme - se informatat e publikuara mund të jenë të përkohshme apo nën standardin e saktësisë dhe besueshmërisë që kërkohet për deklaratat financiare vjetore.

3. Përbushja e kërkesave të konsumatorëve

Nën përgjegjësinë e ZLE, Kompania teston rregullisht kërkesat e konsumatorëve të saj dhe shërbimet që u ofron atyre, i miraton procedurat adekuate dhe harton raport të shkurtër e të qartë, në të cilin cakton nivelin e përbushjes së kërkesave të konsumatorëve dhe komentet e ZLE për çfarëdo ndryshimi material në lidhje me nivelin e përbushjes së kërkesave të konsumatorëve.

4. Interesat konfliktuoze

Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit hartojnë rregullisht ose kur kjo është e nevojshme - të paktën çdo tre muaj - një raport të përbashkët, të shkurtër e të qartë, në të cilin përfshihen të gjitha rastet që cilitdo prej anëtarëve të Bordit të Drejtorëve apo zyrtarëve të Komisionit të Auditimit ka deklaruar ekzistencën e konfliktit potencial të interesit personal dhe ka abstenuar nga votimi apo nga veprimi, duke shpjeguar natyrën e interesit dhe vendimin që ka çuar deri te kjo. Pjesë të këtyre informatave mund të mos publikohen, në rast se konsiderohet e arsyeshme që konfidencialiteti i tyre të ruhet në interes të Kompanisë, por këto informata përfshihen në raportet e mëvonshme, kur ruajtja e konfidencialitetit konsiderohet e panevojshme; Në asnjë rrethanë nuk mund të mbahen informatat në interes të drejtorit apo të zyrtarit relevant

5. Transaksionet me palët e nderlidhura

Komisioni i Auditimit harton rregullisht - të paktën një herë në tre muaj - raport të shkurtër e të qartë, në të cilin përfshihen transaksionet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me palët që nuk i ka miratuar (duket përfshirë arsyet për hedhjen poshtë të tyre), si dhe të gjitha transaksionet e miratuara që kanë të bëjnë me palët (duke përfshirë: lartësinë e transaksionit; sasinë e bilanceve të mbetura, kushtet, afatet dhe garancitë; dispozitat për borxhe të dyshimta që kanë të bëjnë me shumën e bilanceve dhe shpenzimet që janë të njohura gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija apo të dyshimta për shkak të palëve përkatëse relevante) dhe një deklaratë se kjo e fundit ka qenë e arsyeshme dhe e drejtë për Kompaninë. Një pjesë e këtyre informatave mund të mbahen, në rast se për këtë çështje konsiderohet e arsyeshme që të ruhet konfidencialiteti, në interes të kompanisë, por informatat e tilla përfshihen në raportet e mëvonshme kur nuk më ekziston nevoja për ruajtjen e konfidencialitetit; në asnjë rrethanë nuk mund të mbahen informatat në interes të palës përkatëse relevante.

6. Ueb-faqja

Kompania, nën përgjegjësinë e ZLE, krijon dhe (azhurnon) përditëson rregullisht, ueb-faqen e saj, në të cilën publikohen të paktën këto informacione:

- (a) dokumentet e përcaktuara në nenin III(4)(j) dhe raportet e dokumentet e Komisionit të Auditimit;
- (b) raportin e auditorit të jashtëm në lidhje me deklaratat financiare të përcaktuara me nenin III(4)(j)(i);
- (c) raportet e përcaktuara me nenin VIII(1) deri (5);
- (d) listën e kontratave më të rëndësishme të prokurimit që janë lidhur në vitin financiar aktual, ku pasqyrohet natyra, çmimi dhe pala tjetër (pa asnjë paragjykim ndaj obligimit për ruajtjen e konfidencialitetit që i detyrohet kësaj të fundit);
- (e) listën e të gjitha kontratave të prokurimit që janë lidhur në vitin financiar aktual, pa e ndjekur procedurën e tenderimit, ku përfshihet edhe natyra, çmimi dhe pala tjetër (pa asnjë paragjykim ndaj obligimit për ruajtjen e konfidencialitetit që i detyrohet kësaj të fundit) dhe arsyet për të cilat nuk është ndjekur procedura e rregullt e tenderimit;
- (f) lista e 10 (dhjetë) furnizuesve më të rëndësishëm të kompanisë, sipas vlerës së furnizimeve;
- (g) çdo padi apo rast në shqyrtim, i cili ka të bëjë me validitetin e zgjedhjes së një drejtori, shkeljen e detyrave të mirëbesimit nga drejtorët dhe zyrtarët apo me validitetin e çdo vendimi të miratuar nga Bordi i Drejtorëve

Të gjitha këto informata dhe dokumente ndahen në pjesë të veçanta, në mënyrë që të gjenden lehtë, me vegëza në dokumentet tjera, kur është e përshtatshme, që përfshihen në një pjesë të vetme të ueb-faqes që i dedikohet paraqitjes publike të çështjeve korporative dhe radhiten thjesht, në mënyrë që të mund të lexohet lehtë secila prej tyre, dhe në format që mund të shtypet lehtë.

SEKSIONI IX

TË NDRYSHME

1. Viti Financiar

Viti Financiar i Kompanisë përputhet me vitin kalendarik.

2. Hyrja në fuqi dhe shfuqizimi i Rregulloreve të Kompanisë

Këto Rregullore hyjnë në fuqi në ditën e shënuar më poshtë dhe publikohet në ueb-faqen e Kompanisë. Në ditën që hyn në fuqi këto Rregullore, shfuqizohen Rregulloret paraprake, miratuar më 22 dhjetor 2005.

Dorëzuar dhe ekzekutuar në Prishtinë, Kosovë, më 23 dhjetor të vitit 2009




Nexhat Podrimaj, Sekretar Korporativ i Kompanisë

Person i autorizuar, në pajtim me Nenin 13.7(a) të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 2007/02-L-123 (i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2008/26).